

## INTERVISTË ME LALA MERIDITH VULËN

Prishtinë | Data: 22 korrik, 2016

Kohëzgjatja: 57 minuta

Të pranishëm:

1. Lala Meridith - Vula (E intervistuar)
2. Lura Limani (Intervistuesja)
3. Noar Sahiti (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{}* - e intervistuar shpjegon me gjeste

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

*[Intervistuesja kërkon nga folësjja të prezantohet dhe të flet për fëmijërinë e saj. Kjo pyetje shtë prerë nga video-intervista.]*

**Lala Meredith-Vula:** Unë jam Lala Meredith-Vula, kam lindë në Sarajevë në vitin 1966, në Bosnje Sarajevën. Baba im është gjakovarë edhe mama ime është englezë prej Anglia, edhe janë taku se mama im ka studju gjuhën serbisht edhe kanë taku në Jugosllavi, ish-Jugosllavi edhe pastaj janë martu edhe baba im ka qenë në fakultet për arkitekturën ne Beograd po pastaj ka marrë *turn* [Ang: drejtimin] në Otoman [arkitekturë osmane] edhe ka vendosë në Sarajevë edhe aty jam lindë në Sarajevë.

Kanë jetu katër vjetë bashkë pastaj janë divorcu edhe unë kom kthy në Engli me mama ime në vitin 1971. Edhe aty s’kam, vetëm bosnjanisht kam ditë, nuk e kam ditë as shqip as englisht, edhe kom fillu të mësoj englishtën, kom harru bosnjanisht edhe me moshën 16 vjeç se po flas *forward* [po eci pak shpejt] që... kam ardhë prap në Kosovë edhe kam taku gjithë familjen. Babi im, e kam pasë edhe tre motra nga babai se babai im ka martu prapë, po nuk kam ditë me fol me ato se ata nuk dinë englisht. Kam pasë ca kusheri që kanë ditë englisht, flet serbisht edhe flet shqip, unë flet asnjë gjuhë vetëm në englisht edhe i bojmë pamtomimë atëhere për me komuniku.

Por jam befasu për të mirë, për me kulturën edhe u konë viti 1982, jom befasu për të mirë domethonë me kulturën edhe pse për situata politik atëherë në ‘81 ishin demonstratë. I kom pasë edhe axhat, disa axhat në burgj[e] me Adem Demaçi, domethanë taman familje politik kam pasë, edhe i kam vrejtë që diçka një enërgji për liri, kam vrejtë a din, edhe më ka lënë një [për]shtypje për të mirë. Edhe atëherë me moshë 16 vjeçare kom mendu do të kry shkollën në Engli dhe do të vi mas shkollës dhe diplomës më msu shqip që me mujt me fol me halla ime, me axhat, me babai, kryesisht babai se gjynah mos me fol me babi edhe motrat.

Edhe në vitin 1988 kam diplomu nga fakulteti i artit Goldsmiths, London University [Univerziteti i Londrës] edhe kam ardhë me jetu në Kosovë, edhe atëherë ka qenë shtator viti 1988. Edhe atëherë

nëse majë mend, se unë erdha, edhe po ju thashë shoqet në Engli, “Po shkoj në Kosovë” po thojnë, “Ku është Kosovë?” Se si një vend nuk e dijnë ku është! Edhe atëherë Slobodan Miloseviç, ka... nuk e di fiks, po ishte, ka dashtë me ndrru planet në Jugosllavi, nuk e di fiks çka ka qenë, e dinë politikanët ose historianët. Edhe kanë fillu greva në Trepçë, domethonë sa jam ardhë ka fillu greva në Trepçë edhe gjithë problemet prapë, edhe del [në] Kosovë, në lajme në Engli edhe krejt kanë thonë, “Qe Lala u shku atje edhe s’kemi dëgju për Kosovën”, tash ka dal në lajme të Londrës të Englisë. Domethanë prej... domethanë kam jetu 1988 për tre vjetë kam jetu në Kosovë, domethanë i kam pa të gjitha ato demonstrate, isha në demostatë këtu në 1989 edhe gjithë shoqëri, se kam kry shkallën e tretë këtu për fotografi.

Atëherë unë isha me një klasë fillestarë me fakultet, shqip, një klasë fillestarë në fakultet filologji edhe krejt rastësisht në të njejtin klasë, në të njejtin dhomë në fakultet [k] ishte estetikë me Rexhep Qosja. E unë kam dëgju, Rexhep Qosja është shkrimtar i njohur edhe estetikë po jep, edhe rastësisht kam shoqëru me një vajza, student i Rexhep Qosjes edhe kom thonë, “A bon unë me hi në kllasë kështu edhe me dëgju atë ligjeratë të Rexhepit?” Edhe kom hi qeshtut në... ligjeratë, e kam bo shoqe të ngushtë me këtë shoqën Violeta Bardha, e ajo babën e saj [k] ishte në Aksion për Pajtimi i Gjaqeve në Drenas atëherë. Kjo u konë në 1990, fillimi i ‘90. Edhe ajo më ka lut, “Hajde se po bëhet pajtimi i gjaqeve, një tubim i madh”, e ajo më ka lut. Edhe une i thashë, “Jam lodh.” I kam pasë programet e mija se isha t’u fotografu fshatra, se më kanë pëlqy kullat. Babai im ka pasë lëndë arkitekturën dhe ai ka pasë... shkonte nëpër fshat me fotografu kullat, edhe une kam pasë shku pas babit me shoqëru, të boj fotografi [të] mullar t’sanës edhe fshat, si punon në fshat.

Më kanë befasu, kjo është koha e vjetër qysh kanë mbet këtu, kurse në Engli është krejt me maqinë si i bonë në farmë, në bujqësi. Edhe më ka befasu për të mirë edhe une dashta me e fotografu këtë, kur Violeta tha, “Hajde me pa këtë pajtimin e gjaqeve”, e une në fund thashë, “Ani, hajde”. Une, a din, [u] dorezova se ka insistu. Kur kam ardh në Skenderaj, u konë në mars në 1990, edhe aty ishte ni tubim jo shumë i madh, ama mjaft e madhe, edhe e pash se diçka, nuk i kuptova gjaqet çka domethonë se nuk kam ditë shqip mirë, veç e kuptova që është diçka shumë ransishme nga emocionet e njerëzve. Ishin bashku krejt fshatra edhe krejt rreth fshatit tjera, Skenderaj, Drenas, ajo ka jetu afër Drenasit. Domethonë i kishin bo tubime krejt edhe pastaj Anton Çetta ka ardh me profesorat. Shefqet Pllana ishte aty, dhe ai ishte dekanı në Fakultet Filologjik që unë e kam njoft, ose rektor i univesitetit (qeshë), spo di u konë dikun i njohur i universitetit. Une e kam njoft këtë edhe pastaj më prezanton me Anton Çettën. Edhe pastaj e mora vesh që ishte diçka me shumë rëndësi edhe më tregoi se këtë gjak po fal këtë gjak edhe publikisht kanë fal gjakun.

Pastaj unë përcolla do pajtime tjera nëpër Kosovë në vende të tjera dhe kam fillu me u interesu ma shumë për pajtimin e gjaqeve. Kam fillu me shku me Anton Çettën nëpër fshat ku kanë gjakun për t’i lut me ia fal gjak domethonë, ato grupet që shkojnë përpara me pajtu publikisht. Ishin një delegacion, me siguri ke bo intervistë edhe me ato që e bojnë grupin, që me Anton Çettën shkojnë për me lut për

me fal në fillim.

Pastaj jom kthy në Londër në vitin '90, fundi i vitit '90 kah dhjetor. E kam taku BBC, edhe e kam lut BBC duhesh me bo një program për këtë fenomen që është në Kosovë, që ka njerëz që e fal këtë send, që është shumë vështirë me ia fal gjak. Edhe ishin interesuar një regjisor i BBC, i njohur, edhe jam ardhë kah viti '90, fundi i vitit '90, jam ardh me kete regjisorin e BBC, jemi shku te Anton Çetta. Jemi shku te ni gjak, e kemi pa nje gjak. Jemi shku me delegacion edhe kam pa nje gjak tu fal. Momenti kur vendos familja qe do të falet, edhe Anton Çetta i ka bo bindje, ishte diçka shumë, qysh me thonë *moving* [e prekshme] a din, domethonë jep emocion, vërtetë diçka e madhe me pa, me qenë deshmitar i diçka qaq e madhe.

Pastaj jemi kthy Londër dhe kemi lutë BBC na sponsorizon, me sponsor filmin. Pastaj në vitin '91 kam ardh me ekip BBC, me regjisor, me kameraman, me soundman, si ju tani po boni me video. Po atehëre kemi bo me film 35 milimetra, edhe me soundman {tregon me duar} vjen me qajo, taman ekip a din, regjisor, une, e kemi marrë përkthyesin. E kemi angazhu Anton Çetta, e kemi angazhu ku do jetë dhe e kemi gjetë dhetë familje që janë në gjak, se kemi vendos se do të bejmë një film të percjellë një familje, se e ke parasysh englez nuk kanë qef me jep dokumentar të ftoftë, me thonë qikjo, qikjo, qikjo, po kanë qef naj stori, naj tregim personale. Ideja është me gjetë një famili para se me u falë gjaku, me gjetë edhe me filmu momentin që do me falë gjaku, deri sa t'jep dorën vrasësit para shikuesve. Edhe kjo ishte ideja. E kemi gjetë dhetë familje në gjak, edhe ai regjisorin u shku ka vendos me koncentru me nji familje, edhe e kemi bo film.

E kemi percjellë një burrë, e këtë burrë nga fshatra Shkozë, ne Malishevë, në rrethet e Malishevës, ai i ka pas 21 fëmijë. Dy gra edhe 21 fëmijë (qeshë). Edhe ishte nje burrë, a din, taman burri burrë, taman me tradita. Edhe kemi bo një film, ai që e kishin myt djalin e madh te këtijë. Një komshi e ka myt merre me mend! Edhe kemi filmu delegacionin t'u shku në vrasësi t'u bo lutje, pastaj të shkon te ai njeri që duhet me falë gjaku, e pastaj me u pergjigj, a din shkon me intervenu te të dytë familjet deri sa te vjen te pajtimi. Domethonë procesin kemi percjelle prej fillimit. Edhe ishte, ka qenë periode shume e veshtire ketu në vitin '91, domethonë jemi fshehur kamera, sepse domethanë bile për me marrë lejen BBC, jemi shku te serbët edhe kemi marrë lejen. Po thotë, "Pse, ça po filmon?" Se s'po donë me i thonë Anton Çettës, edhe po thom, "Jo, po bojmë kështu jetën në fshatra", edhe kemi filmu [një] serb, një familje serb, një familje shiptar që janë në gjak që me jep shikimin me balancë. Jo me thonë një pikëpamje, a din, shiptartë të Kosovës, por edhe serb. Domethonë, pak ma barabar për anglez, mos me pa prej një ane, por me pa gjithë pamjen e Kosovës. Domethonë kemi marrë nji familji serb edhe një familje shiptar dhe kështu kemi bo film dokumentar.

**Lura Limani:** Familja serbe a ka qenë në gjak me familjën shqiptare?

**Lala Meredith-Vula:** Jo, jo, jo, ata nuk ishin në gjak, por ata jep... veç ishin një familje e thjeshtë, edhe nuk kemi krahasu, veç kemi thonë qikjo është [për] Kosovën, këtu është një familje serbe. Edhe pastaj

jemi vazhdu me familjen shiptare që janë në gjak edhe po e falë gjakun. Veç me të jep një përmbajtje, një kontekst, i filmit dokumentar, por shumica e filmit ka qenë për pajtimin e gjaqeve. Ama, kur e kemi marrë lejën e kemi thonë, “Do të jetë me serb edhe me shiptar, gjysë-gjysë”. Se nuk na lejonin me filmu, nuk e lejon BBC me ardhë. Se duhej lejen, e patentën. E edhe me shumë vështirëi sepse jemi shku me dy kerre, [për] shembull nepër fshatra, e një kerr ka qenë me BBC, e një me Anton Çetten. Pastaj përkthyes, pastaj mos po na kapin me Anton Çettën e dijnë çka bojmë, a din.

Taman, kemi pasë kjo pak cirkus për me mshef këta shka jemi ka bojmë. Edhe me siguri kanë ditë se, po në fund, edhe bile, edhe çdo herë që kemi filmu ato filmat, janë ardh në kuti filmat se ishin të vjetër film. E çdo ditë kur krym xhirimet, njonin ish shku ne Beograd edhe u kthy në BBC qat’ ditë qato që kemi filmu, se na po presim përditë na marin filmat, a po kupton? A din, mundet na, na ato të Jugosllavisë kish mujt me marrë filmat se kemi dëgju që qeshtu ka mujt me bo. E përditë i kemi marrë dikush që shkon në Beograd edhe me ikë sa ma shpejtë me filmin. Kështu është tregim gjithmonë dikush që filmon këto, sidomos politikë që po, politikanët gjithmonë... Edhe unë kur kam qenë në pajtimi i Verrat e Llukës, me 1 maj aty isha t’u bo fotografi edhe dëgjova se janë ka marrin gazetarët filmat, se atëherë në film marrin edhe djegin kshtut {shpjegon me duar}. E dëgjova se t’u ikë njerzit prej pajtimi janë t’u ndalon gazetarë dhe janë t’u marrë fotografi sidomos edhe janë tu marrë, kanë marrë filmat. E unë jam fsheh me një famije, katër orë kam fsheh deri sa të gjithë kanë ikë prej Verra e Llukës, pastaj vetëm jam nisë mos me bjer në sytë policive.

**Lura Limani:** Para se të pysë për kto, desha me u kthy me një pikë ma herët që e përmendët, që në njëfarë mënyre aksidentalisht keni fillu me i përcjellë?

**Lala Meredith-Vula:** Po... po

**Lura Limani:** A keni qenë gjithmonë duke fotografu, a e keni pa rolin e juv si dokumentuese apo keni qenë pjesëmarrëse?

**Lala Meredith-Vula:** Është pyetje e mirë se unë jam piktore dhe jam artist, nuk jam politikan. Edhe unë... artistat e merr për frymëzim prej jetën e vet, e unë shembull si *Van Gogh*<sup>1</sup>, shembull ai i ka pikturu lulat, kopsht edhe gjithë gjërat rreth *Van Gogh-u*. E unë i kam pikturu në mënyrën e fotografisë e kam kap jeta rreth meje, e domethanë që dola në Pajtimi i Gjaqeve, i kam kapë, pamjet i kam kapë nga çka unë personalisht më ka lënë [për]shtypje, e jo që po mendoj qe do të reklamoj ose do të bo artikull dikun për lajmet ose gazetë. E kjo është e rëndësishme në arkivin tim, se nuk e bona për një... redaksi ose një drejtor ose për një arsyetim, por për... veç për artin. Çka ka dokë ma estetik edhe ma bukur edhe ka përshkru momentin ma shumë personalisht për mu. Edhe është fenomen interesant se e kam arkivin edhe është dokument por është shumë dokument personale moment që kam jetu përjetu në Kosovë ato vite por tash është bo vlerë për publik, si lulat që ka bo *Van Gough*. Se qetash po

<sup>1</sup> Vincent Willem van Gogh ishte një piktor holandez Post-Impressionist i cili njihet si ndër figurat më të famshme dhe me ndikim në historinë e artit perëndimor.

du me fy *Van Gough* (qeshë), demek jam të njetin nivel, e ai ka bo lulet e diellit, lula diellit kemi gjithë botën, por ky e ka pikturu me gjithë shprehjet e këtij. E unë kam dëshirë me [u] përpiqë që të bëj art ashtu me gjithë emocion të mija. E kjo ishte idea.

**Lura Limani:** Çka kanë qenë gjanat që i keni mësu ma së shumti t’u e përcjellë Anton Çettën edhe t’u marrë pjesë? Ju e përmendët pak që keni qenë aty kur kanë ndodhë pajtimet. A mundeni me na përshkru pak ma shumë procesin se si ka ndodhë një pajtim edhe pajtimitarët...

**Lale Meredith Vula:** Po, kemi edhe në film të BBC-së e kemi bo ato edhe me siguri ti ke bo, o do të bo me ato studentat që kanë qenë të burgosur. Ishin një femër pejon, kam harru emrin e saj, me siguri është shumë e njohur edhe ajo u tregonte si ishte në burg edhe domethonë më ka lonë përshtypje e madhe se kjo ishte në burg edhe ka pa njerz me gjakë që janë në burg edhe qitu lind idea. Edhe ka bo [thirrje] në radio edhe pastaj ka fillu kjo aksion e madhe. E me Anton, ata rinisë edhe kryetarë e katundit gjithmonë e din kush është në gjak. E i cakton, kemi dhetë njerz në gjakë, kemi sa person në gjak në këtë edhe ata, i kish lajmru që dhetë gjak kemi edhe ata fillon që të lutë, “A bon, a po don me pajtu?” E ato ma vështirë i thërrasin Anton Çetta, e thërrasin ai Don Lush Gjergji, ky bre, ai hoxha, ky...

**Noar Sahiti:** Mulla Xhevati...

**Lale Meredith Vula:** Mulla Xhevati... (buzëqeshë) A ke bo intervistë Mulla Xhevatit a? Ah sa i mirë është... domethenë, për me të ardhë në oborrin, në odë edhe me lutë me bo kjo, se është e madhe me lutë kjo gjakderdhje, a din është gjëra... Me lutë shkojke, pleqt, domethonë pleqt [shkojshin] te ai që ishin që ka humbur gjak. Edhe ato çështje ma vështirë thotë, “Jo, s’po du me fal, se naturalisht që vlla e kam çunin e kam edhe s’du me falë gjakun”. Edhe Anton e lutë edhe a din tha, “Në emrin e popullit shqiptar, po lysim [lusim]”. E masi që osht’ Anton Çetta si Ismail Qemaili me ardhë me thonë, a me lutë qetu. Ti ki me thonë po, a po?

Qeshtut se Anton Çetta u konë legjendë në jetën e ktij edhe jo, ka meritu se ai edhe me gjithë folkor si ka folë, a din. Ai thotë prapë, “Atë gjak,” thotë, “vështirë noshta,” tha, “s’po du me fal”. E Anton tha, “A e... maj mend kjo Isaku, Isaku me kali të bardhë që ka ardhë...” (qeshë) e ka një shtos, a din, e katundit edhe një përallë një anektodë. Edhe futë ai [në] imagjinatë, i futët, futë qaj njeri në gjak edhe pastaj [ai] thotë, “Jo, s’po du me falë”. Pastaj e lutë edhe një herë, edhe një herë... deri sa të thotë, “Ju pleqt e familjës shkoni jashtë vendosni” edhe na delegacion presim në dhomë, bile s’jemi t’u marrë frymë, jemi qaq [të shqetsumë] jemi t’u pritë. E kur ardhin prapë familja thotë, “Na kemi vendosë me ja falë gjaku”, për shembull, edhe gjithë hypim në kamë edhe përqafemi, edhe kshtut është a din si kanë bo ato për me pajtu gjaku.

E pastaj ata i kishin vendosë ku me ia falë publikisht edhe qeshtut janë bo tubime me organizime. Por kur isha në tubime e Bubavec e Malishevës edhe data kam harru prill ndoshta a maj 1990, *anyway* [sidoqoftë]. Qaty është befasi se kishin organizu tubime e gjithë ishin ardhë pa, dyqysh [të thirrun] me gojë pa, nuk e kom ditë kur po fillon tubimi, veç vjen njerëz edhe mbledhë edhe fillon, vjen Anton

Çetta edhe fillon. Vjen ai me çifteli qe ka lujt çdo herë muzikën në Pajtimi e Gjaqeve. Ai është një kongëtar i njohur, gjithmonë ka këndu, edhe ai ka ardhë, plotë edhe pastaj bohet, edhe ata e fshatrave kanë lexu poezi, pastaj kanë thirrë çdo gjak në listë në qat’ fshat, me vrasësi, familja e vrasësit ose me vrasësi. Edhe ai vrasësi i familjes dhe ai që falë gjakun rrinë edhe e përçaf para Anton Çettës edhe gjithë, a din bonë me dorë [duartrokasin], a din? Se për me bo këtë aksion është shumë e për qeto është e rëndësishme që e bonë para publiku, si me festu diçka, si me tregu diçka të mirë edhe për qato kishin organizu tubimet. Plus më duket që edhe me Kanun është që kur falë gjakun duhet me mbledhë krejt fshatin që bon para publiku, me thonë këqyre une fala gjaku si zyrtarisht me jep informacion. E qekjo është tradita me fal me një pajtimi i gjaqeve.

## Pjesa e Dytë

*[Intervistuesja e pyet folësen nëse ka fotografuar momente të tensionit mes forcave serbe dhe pajtimtarëve në Aksionin e Pajtimin të Gjaqeve. Pyetja është prerë nga video-intervista.]*

**Lala Meredith-Vula:** Po bile, njo që kom fotografu në Gjonaj e kam fotografu gjithë tubime, e mrapa ishin nja shtatë tanka, tanka të Jugosllavisë. S’e kanë përdorë, por i kanë parku qaty me ditë kush osht’ (qesh), a din, me ditë kush osht’, a din t’u udhëheq shtetin. Domethonë, ishin shumë opresion psikologjikisht edhe... ama, isha tash t’u mendu, mere me mend kur bohet futboll për shembull me shumë shikus kur i ki shumë publik, shumë njerëz gjithmonë polici duhet aty se edhe mundet me shty njerëz edhe mundet gjithçka me bo. Ama, merre me mend asnjë polic veç njerëz jonë ardh me mij mij person pa [apel publik] veç organizua mes njeni-tjetrin, pa polici t’u prit [mbajt rend], pa vetëm ato jugosllav që ishin pak ma larg. Domethonë, ishte e madhe aty organizimi popullore ishte, krejt popullore edhe shumë... edhe popullore me gojë bile e kishin bo lajmrimin. Merre me mend, [sot] na duhet edhe me data edhe me shkrujt pllakat edhe me qit’ pllakat edhe me qit’ në fejsbuk [facebook] e me data, me caktu me ora, me caktu.... E atëhere veç me goja, “Hajdeni, maje dikun në fushë Verrat e Llukës bojmë pajtim gjaqeve.” Ama, aq shumë njerëz kishin krejt Kosova kishin dashtë me të ndrru sendet, a din? Krejt kush ka ardhë në qat’ tubim ishin me njejtin mend për liri, për për paqe, për për të mirën e qitu. Ishte ni ndjenjë e shof nga ftyren e njerëzve, si po thu të gjithë janë ka falë gjak. Ishin vertetë, a din, moment. E unë edhe ti je i re, ti s’e din që je ka jeton historinë veç kur plakësh dihet që, “Ku-ku, kam jetu në 2016”, a din, se ndryshon sendet kaq shumë në jeta jote, do ndryshon që, që je bo plakë edhe pastaj atë që ke jetu përpara osht’ në arkivë a din osht’ në muze (qesh).

**Lura Limani:** Ju keni qenë t’u nejt në Prishtinë në atë kohë apo?

**Lala Meredith-Vula:** Po, kam jetu në Prishtinë, kam pas famili në Gjakovë edhe famili në Prishtinë. Edhe kam bo edhe shoqni me njerëz në fakulltet artit që isha lidhur me arkitekt me fakulltet art, artit se kam bo, e kam pasë bursën e Jugosllavisë, se ishin një bursë që ka dhonë Jugosllavi atëherë edhe kam fitu bursën edhe kam bo si shkallën e tretë ktu për fotografi në fakulltet.

**Lura Limani:** Qysh ka qenë jeta në Prishtinë në atë kohë, a ka pasë, momentumin që është kriju në

fshatra me pajtime, a osht' reflektu në jetën që e kanë bo rinia e Prishtinës?

**Lala Meredith-Vula:** Po, ishte me stres jetën, a din, polici gjithkrah edhe gjithmonë organizimi a din politikisht je gjithmonë t'u dëgju, "Qishtut ka ndodh, qishtut ka ndodh", edhe në televizion gjithmonë dhezur, "Në Slloveni ka dalë luftë në Vukovar, luftë gjithë Jugosllavi ka fillu luftë", a din, edhe domethonë ka qenë plot t'u shiku televizion, edhe ni jetë në stres domethonë. A din, unë kam pasë shoqni që kanë qenë aktivist që kanë punu në "Alternativë" [ilegale], përshembull edhe gjithmonë t'u fshehur, t'u mendu shka me bo, a din? Adem Demaçi ishte shliku në atë kohë edhe gjithë vijnë në shpi Ademit, për... a din, kam ardh e kam prit n'rradhë, e krejt publiku kush ka dashtë me pa Adem Demaçi janë shku me hin me të përshendet masi që është shliku nga burgu. Edhe domethonë, qito sendit i kemi marrë, a din taman u konë edhe nifarë lufte civil, sepse thojmë, "A po kena me bo qishtut, kena me bo, kena me prit ktu", a din, edhe gjithmonë duhet me dëgju me qenë e dëgjushëm. Pastaj mas '90, në '91 kam bo vizitë shpesh në Kosovë, deri në luftë kam bo vizitë edhe isha në Kosovë tu bo ekspozita. Kam ardhë edhe me gazetarë, shpesh kam ardhë ktu. T'u jetu në Londër unë gjithmonë kam reklamu, "Hajde po shkojmë me filmu në Kosovë, e bojmë diçka", e edhe në Shipni kam qenë shpesh prapë t'u fotografu gjithë Shqiprinë kam qenë me intelektual që po merr histori në Shqipëri për shembull.

E luftë e Kosovës kur ka përfundu unë kam hi me trupa të NATO-së dhe kam punu me Kryqin e Kuq në qershor 1999. Edhe atëherë kam bo fotografi artistik sepse edhe më ka lonë përshtypje e madhe që njerëzit kanë dashtë me kthy në vend edhe me ndërto prapë. Se une pritsha që njerz kanë me qenë e mërztur, t'u qajtë se luftë u kry, a pe din, por jo, jo, po donë me ndërto shpi, po donë me bo qitu pazar, a pe din, s'po du me prit mërzi për çka kanë hek, por po donë me hec përpara. E kjo shumë më ka lonë [për]shtypje e madhe edhe kam bo një seri quhet "A jeni të gjithë numër?" Sepse e dëgjova se është si fjala kur të shohim njeri mas luftës, sot, "A jeni gjithë numër?" Edhe shpejt kuptohet a ka vdek dikush, a jo. "Jemi numër?" "Ani, shumë mirë. Hajt tung!" Edhe nëse thotë, "Më ka vdekë halla." "Ani, ngushllime!" A din, qishtut numron njeri shpejt edhe diqysh rrugës, "A jeni numër, a jeni numër?" O kshtut njerz takon mas luftës njoni-tjetrin kshtut. Edhe i kam pa për një vjet kam jetu në Kosovë edhe pash njerz t'u kthy prej kampat refugjat prej... edhe ishin minat atëhere edhe ishin mjaft rrëmujë edhe atëhere, por ishin shliku edhe njerz ishin shumë i lumtur, a din? Edhe e dinë vlerën e jetës, atëhere se kush ka shpëtu ka dukë jetën edhe ma bukur që e kanë shpëtu, por shumë njerz ka pasë në burg nëpër Jugosllavi që s'kanë ditë ku janë edhe domethonë s'u kry problemat, po qishtut.

**Lura Limani:** Çka ka ndodhë me familjën e juj në Gjakovë?

**Lala Meredith-Vula:** Poo, knena njonin knena, a din, kush ka mujt me ik qishtut. Na s'kemi ditë ku kemi pasë hallat, halla u ik në komë, halla u ik te Tiranën, baba im tërë kohën ka nejt në Prishtinë. Një motër e vogël kam pasë ktu në Prishtinë edhe baba im, une gjithmonë thom, "Babi, ik, ik!" Tha, "Po, une jam plak", a din, nuk, nuk... Edhe nime, ai nuk të vëmend një plak, se djemt e ri mysin apo se nuk donë me i fut në ushtar, por një plak i vjetër e kanë lanë me hi me shetit lirisht. Edhe u shpëtum, a din, edhe ai, baba im ka nejt me një podrum me burrat, pleqt që kanë metë gjatë luftës ktu e gjithmonë rrijnë. Edhe pastaj kur largohen thojnë ndoshta nuk shihemi nesër, por shihemi a din edhe qishtut, gjatë luftës ai ka jetu në Prishtinë. A din, janë shpërnda nëpër... sidomos në Gjakovë e kanë djeg



shumë edhe të gjithë janë shpërnda janë shku në kampa, sa janë shku në mal, ku ka mujt me shku janë shku.

**Lura Limani:** Deshta me u kthy edhe pak, e përmendet që keni ardhë në Kosovë me një bursë të Jugosllavisë për artista, a ju ka ra me udhëtu në Jugosllavi në atë kohë?

**Lala Meredith-Vula:** Po, po, kam qenë në Zagreb edhe në Sarajevë se e kam percjell teatrin edhe art edhe Beograd, domethonë në kto qytete kam prezentu në fakulltet i artit edhe kam njoftu pak lëvizjen në art. Ekspozitën e parë që e kam bo ka qenë “Hrvatski Likovna”, Qendër për Art të Bukura në Kroaci e kam shfaq, “Mullarët e Sanës e Kosovës” kshtu (qesh). Edhe kanë thanë që është skulptore e Kosovës prej sana, a din nga natyra osht’ bo. Edhe kam bo ekspozitë në vitin 1990 në Kroaci edhe ktu Boro-Ramiz, tash shtëpi si quhet Boro- Ramiz?

**Lura Limani:** Pallati i Rinisë...

**Lale Meredith-Vula:** Po, Pallati Rinisë kam bo ekspozitë në 1990, edhe atje për mullarë të sanës, jo për pajtimi i gjaqeve a najsend (qeshë).

**Lura Limani:** I kom pa fotografijat që i keni bo n’atë kohë, shumë interesant jonë.

**Lala Meredith- Vula:** Pse, ku je lindë ti?

**Lura Limani:** Po mendoj unë, jo, jo nuk i kom pa në origjinal, jo.

**Lala Meredith- Vula:** Aaaa..

**Lura Limani:** ‘88 jom.

**Lala Meredith- Vula:** Thashë, boll e re me pa origjinalin, ti je konë bebë , as s’je lindë . Ti je lindë ‘98

**Lura Limani:** Jo, ‘88, ‘88.

**Lala Meredith- Vula:** Thashë koke (qeshë)... ‘88 je lindë?

**Lura Limani:** Po.

**Lala Meredith-Vula:** Avvv, ani kur jam ardhë unë, ti je kanë bebë .

**Noar Sahiti:** Dy vjet, a, a p’i bjen dy?

**Lura Limani:** Jo, ‘88 ka ardhë.

**Lala Meredith-Vula:** Unë në ‘88 kam ardhë, po. Cilin muj?

**Lura Limani:** Korrik.

**Lala Meredith-Vula:** Korrik, ani qaty dikun jam ardhë, shumë mirë.

**Lura Limani:** Po ndërlidhën.

**Lala Meredith- Vula:** Po, po.

**Lura Limani:** Po, deshta me ju pytë çfarë funksioni kanë pasë artistat për ju, se ju sigurisht ju ka ra me njoftu edhe në Kroaci.

**Lala Meredith- Vula:** Po, po, qysh jo. Artistat gjithmonë janë kundër ligj, për të vërtetën, për, për liri, për mos me shaj, mos me gënjej. Ishin edhe në Beograd artistët, nuk e kanë pëlqy Slobodan Misoleviçit edhe kjo nasionalizëm që kishin ardhë. Hmm por, ishin shumë ato lajm, kërkush s'ka shku në Kosovë, se unë jam shku në Sarajevë edhe kur po thom po vij prej Kosovës thonë “Ku-ku-ku-ku, a din, i egër është”, u kanë thanë, a din edhe ishin intelektualë të Sarajevës edhe intelektual të Beograd, po, po akoma po kujton që Kosovë ka njerëz i egër se lajmet e kanë dhanë qashtut edhe kumeditë.

Edhe unë thashë, “Jo, është...” edhe kaniherë unë thashë, a din, “njerzë janë [të] mirë në Kosovë, a je, a je kanë në Kosovë?” Tha. “Jo.” “Ani, qysh e din që pra?” Edhe pastaj kam marrë... sepse Jugosllavi edhe serbtë kanë pasë televizion të Jugosllavisë. Edhe e kishin reklamu edhe lajmet e kishin jepë se, “Srpski, separatisti, shiptarski separatisti, iredentisti”, edhe thotë, “se kjo Kosovë donë me u largu prej Jugosllavisë” edhe diqysh, edhe në Sarajevë e maj në mend boshnjakçe unë kam thonë “Jo s’është qashtu” a din, po thonë “Jo, jo, ju keni pare në Kosovë edhe po don me t’nda prej Jugosllavisë edhe jeni mafiozë”, edhe tulifar gënjeshtër. Edhe po, pastaj kanë marrë vesh, kur ish bo edhe luftë në Sarajevë [e kanë kuptu] qysh me kon kanë punë, a din? Nuk po thom për serbët, por po thom pushtet, pushtet Jugosllave ose Slobodan Miloseviçit.

Artistat jonë kanë shumë [të] mirë edhe më kanë pëlqy po, shumica artistë se ka ditë për Kosovën e vërtetë, pastaj kur del diçka kundër në gazetë të Londrës, diçka që është përkrahë shqiptart ata thonë se e kishin, e kishin shitë e kishin bo jo e kishin rek... e kishin jep lajmet gabimisht për Kosovën. Eeee nuk ka besu atë kohë se ishin keq lajmërimi. A kupton?

**Lura Limani:** A ka qenë ndryshe shumë prej secilit qytet n’qytet, domethonë ke jetu në Sarajevë, në Zagreb, në Beograd, keni jetu në Prishtinë, a ju ka dokë Jugosllavia si e ndame edhe para se me ja nisë lufta?

**Lala Meredith- Vula:** Po, qysh jo. Po ishin shumë, shumica e njerëz kurrë s’kanë shku në Kosovë edhe në Slloveni edhe në, ata ishin fasionu me Kosovë në Slloveni po nga rreklamat e keq, propoganda, propaganda është fjala, të keq kanë kujtu se është e egër atje. A din, edhe njerëz edukime edhe shkollume slloven kam... kur po thom, “Po studion në Kosovë”, a din, e kishin pasë si befasi Kosovën se është një vend i egër, domethonë edhe ishte shumë dallim në Kosovë me Slloveni. Slloveni ishte shumë më e zhvilluar, ishte shumë ma si e perëndimit. Dhe në Kosovë ka më shumë varfni, në fshatra

njerëz me kuaj edhe që domethonë ka pasë shumë dallim, edhe në Zagreb ishte ma shumë si Slloveni domethonë. Bosnja ishte më, edhe Sarajeva ishte shumë më gjallë, a din, edhe më bukur Sarajevë, se kishin bo edhe Olimpiadë atje në vitin 1984, Sarajevë ishte shumë më gjallë po ndryshme se Kosovë. Kosovë ishte ma varfër, keni pasë domethonë ndërtesë të bukur, si bibliotekë edhe ato Elektro Kosovës shumë t'bukur, shumë modern, që si t'shkon Marrevcit për shembull qaty ki mi gjetë varfni madhe, që domethonë shumë dallim.

**Lura Limani:** Po, sa j'u ka bo kjo përshtypje juve, se po supozoj edhe masi që jeni kthi në Londër keni vazhdu m'u marrë me art, me fotografi...

**Lala Meridith-Vula:** Po...

**Lura Limani:** Çka keni bo masnej kur jeni kthi, pse jeni kthi në fakt?

**Lala Meridith-Vula:** Jam kthi pse nuk kam mujtë me gjetë punë ktu në Kosovë edhe s... jom kthi në Londër se e kam gjetë... ishte ma mirë për artistat me jetu në Londër edhe kam pasë ekspozitat dhe kam vazhdu me artin. Pastaj jam hin edhe si profesoreshë në fakulltet edhe kam pëlqy të punoj me studentat. Pastaj kam... në vitin '95 me "George Sorosin Fondacion", Sorosi kam shku në Shipni edhe kam m'i ndihmu me themelu ni kurs për fotografi në Shqipëri '95. Pastaj mas luftës ktu kam ardhë me përpiqë them... me i ndihmu fotografi që osht' ktu në... në Kosovë, në Akademi Artit edhe kam bo ni kurs për fotografi ktu. Që domethanë kam mirrë edhe me art edhe me studentat si profesoreshë. E tani jam në Lestër [Leicester], qytet Lestër, ke dëgju për Premier Ligë që kemi fitu në Premier Ligë sivjet...

**Lura Limani:** Leqesteri...

**Lala Meridith-Vula:** Edhe qekjo o hi... le... le... les... Lestesqeri ah?

**Lura Limani:** No, Leqesteri i thojmë shqip...

**Lala Meridith-Vula:** Lestesqeri, sa mirë! E Lesteqeri... Lestesqeri (qeshë) Lestër, Lëster i thojnë!

**Lura Limani:** Yeah, po exactly [Po, saktësisht]!

**Lala Meridith-Vula:** E ksine bre... aty në Universitet të Montfort University unë jom profesoreshë për art, për film edhe për art edhe për fotografi... edhe po... kam edhe një, po boj shumë artin tim dhe po jep msim për art.

**Lura Limani:** A po tregon edhe naj storie tjetër gjatë luftës masi keni hi më Kryqin e Kuq garant t'ka ra me pa shumë sende...

**Lala Meridith-Vula:** Po, po shumë, shumë sene...

**Lura Limani:** Ka jeni konë t'përqendrum, ku jeni shku?

**Lala Meredith-Vula:** Jemi... kemi fokusin ma shumë nëpër, me shkolla fillore se në filim jem... kemi ardhë me analizu shka duhet me bo, se publiku englez e kan donuar 12 milion funta Kryqin e Kuq. Shumë kanë lonë [për]shtypje englezve luftën e Kosovës, e i kemi, kemi bo shumë para Kryqin e Kuq prej dono... donersit, donerë a? Donatorë. Edhe e... me qat' pare jemi shku në Kosovë me kqy... me analizu shka...shka, ku kena me... me vondosë ato pare. Edhe e kemi vendosë që të koncentrojmë në shkolla fillore, që të ndërtojnë shkollat fillore sepse aty kanë fmijët edhe... jemi shku edhe kemi caktu shumë, shumë shkolla fillore edhe i kemi vë para aty. I kemi pasë edhe zyrën... une kam punu n'fillim e pastaj nuk kanë pasë nevojë për mu, se unë isha prej jashtit ma shumë edhe kanë marrë ndërtusë shqiptarët edhe prokthysë shqiptarët ktu, edhe kanë nisë aksion për me ndërto shkolla fillore. E [për]shtypje n'fillim kur kam ardhë mas luftës ishte që pushtet edhe ushtarë kishin përdorë shkollat për vend ku me nejt ushtarët nëpër katundat. Ku ka pasë shkolla fillore në katund, qaty kanë ushtarët sërb edhe e kishin, edhe kanë pasë njerëz aty edhe kanë bonë torturë atje. Që domethanë edhe kanë djegë, edhe kanë djegë mere... zyrën e... i drejtorës edhe bibliotekë të shkolla fillore i kishin djegë, që domethonë të cilët fshatra ku kena qenë i kishin njejt sistem me djegë [zyrën] drejtorin e arxivin, listat edhe me djegë librat.

Me djeg [zyrën] drejtorin e arkivin listat edhe me djegë librat e me lonë klasat ishin bosh ose që domethënë ishte pak si me pastrim etnik domethënë e kane bo ma sistem, "Hajt shko [në] shkollë, djeg bibliotek edhe ik". Edhe qikjo se mas luftës nuk e shoh luftë çka jonë ka bojnë, po shoh çka ka met edhe veç met si dëshmi, qëtu ka ndodh, qëtu ka ndodh. Edhe qishtut natyralisht ishte mërzitshme.

**Lura Limani:** A keni qenë ju tu fotografu?

**Lala Meredith-Vula:** Po, po, kam arkiv.

**Lura Limani:** A i keni arkivu edhe këto fotografitë e shkollave?

**Lala Meredith-Vula:** Po, e kam bo gjithë shkollat çka kam pa e kam bo, për shembull dhomën e drejtorit me shkums djegur i kam ato tabel të shkollës, me karrikat shkollës të djegur qishtu. Imagjino dot s'ka ku, pse me djegë [shkollën e] fmitë? A din, taman i kom bo fotografi që përshkrun budallaki e luftës. Le bre kush i ka bo, a sa kanë vdekë, por osht' budallaki me djegë shkollën, ça përfitim është?

E domethanë kam pa shumë, kam shetitë shumë, plus ishte rrezik me shetitë se kishte mina shumë. E ni dite i kishim bo, ishim bon [shpërthy] një minë, afër ne, jo afër por një kilometër afër, edhe dy djem i kishin hup këmbët në Gjakovë. Domethanë rrezik, a din, edhe ku kom fotografu ndoshta momenti hec knej, kom me eksplodu ku e di e gjithë kanë thonë, "Mo, mo, se minat, mos hin qetu", se për fotografi ke parasysh duhesh me marrë pamje interesant e qe qeshtut po...

**Lura Limani:** A i keni ekzpozë kto jashtë në Angli apo diku tjetër?

**Lala Meredith-Vula:** Po, kam ekzpozë në Angli, kam bo edhe një film për mas luftës. Me ato fotografi

që kam bo ni film e kam shfaq në Dokufest në 2010, në Dokufest. E bona ni film me ni kompozitor ka bo muzikën edhe ishte gjatë luftës, çka kom fotografu mas luftës, çka kam gjetë, shkolla djegur edhe fmitë diqysh, i lumtur veç. A din, se erdh masi u kry luftës u kthyn në vend të vet janë i luftës domethonë fmitë ishin edhe me trauma edhe shof që janë me traum, por janë edhe lumtur që janë gjallë edhe janë u shpëtu në luftë edhe u kry lufte, kjo..

**Lura Limani:** A po na tregoni pak per jeten tuaj në Angli? Ju keni ardh.... Sa vjeç keni qenë kur keni ardhë?

**Lala Meredith-Vula:** Pesë vjeç.

**Lura Limani:** A ... për herë të parë keni ardh pesë vjec...

**Lala Meredith-Vula:** Në Angli po ... m'fal ktu a në Angli?

**Lura Limani:** Prej Sarajvës keni shku ne Angli?

**Lala Meredith-Vula** Po...

**Lura Limani:** A ju kujtohet lufta në Sarajevë?

**Lala Meredith-Vula:** Po, po, po ... isha fmi ka qenë ndryshme e madhe si Londra. Unë vertetë maj në mend kuaj, maj në mend lagje ku kemi jetu, e kam edhe shoqni akoma në qat' lagje atë rrugicë që kemi jetu në Sarajevë. Edhe kam lidhje akoma shumë me Sarajevë edhe... gjithmonë ku jam rrit në Angli kam, e kam ndje këtë lidhje me Jugosllavi edhe me Kosovë edhe... bile, une nuk i kam ditë për gjithë politik e Kosovës se isha fmi edhe nuk me intereson shumë, por kam kujtu që jam Jugosllave. A din? Kur kam ardh në '82 unë msova unë jam Jugosllave, po se unë mësova edhe nuk disha e takova ni shiptar para se me taku familin, "Kqyre," më tha, "mos thuj që jam Jugosllav, por thuj jam shqiptare." Edhe tha, "Unë jam shqiptare!" Më msoj qysh me thonë, "Unë jam shqiptare." Kur e pash familje i thashë, "Unë jom shqiptare", u gzunë, a din me... uee {onomatopeike} me thanë pak fjalë gzohen kaq shumë, a din (qeshë). Qaty e kuptova pasion, a e din qikjo do të thotë nga ku je, domethonë origjinat janë fort, gjaku ma i fortë se uji.

**Lura Limani:** A e keni marr veshë ma vonë masi që jeni ardh sa komplekse ka qene situata ktu, a veç keni me fillu ma herët para se me vendos me ardh edhe nuk e dinit?

**Lala Meredith-Vula:** Po.. hmm na kemi një fjalë anglez, "Balkan dhe Ballkanizu" është fjala që shumë njerz që nuk, që ndahen edhe që nuk shkon mirë. Balkan i kanë, [nuk] e kanë raport, që janë shumë njerz diqysh, po bona argument [grinden]. Domethonë, grek me turk, osht' vendi me shumë njerz, shumë fise, që domethonë reputacion [të keq] përpara se me ardh i kam ditën për Ballkan. Plus Luftën e Parë Botorore ka fillu në Ballkan, domethonë është taman vendi me rrëmuj. E kam ditë që është kompleks, por nuk më intresonte se isha.... Jam artist, si gjitha artista janë fiksu në artin e vet, nuk

jemi politikan, nuk jemi historin, jemi në ëndrra ma shumë si Van Gogh (qeshë) e fyj prapë Van Gogh...

**Lura Limani:** Po, jo, po ju pys për shkak se në qat' kohë i keni kthyer raportet e para me familjen e juaj në Kosovë, që thotë edhe vet s'e keni pasë idenë që jeni shqiptare, por jugosllave kështu që...

**Lala Meredith-Vula:** Po...

**Lura Limani:** Interesant me pa qysh e keni kriju qat' raport me familjen e juaj.

**Lala Meredith-Vula:** Po, e kam... nuk i kam bo pyetje ose s'kam mendu se qetu jam, a din, edhe ti nuk thashë, pse s'jam anglez apo amerikan? Po qeshtut jam edhe qeshtut kam trashigimin. Veç e disha që njerzit janë shumë t'ngroht edhe kjo më ka pelqy shumë. Edhe familja plot [e madhe], se anglezt një familje një fmi, a din, pak familje. E maj në mend kur erdha [në] '82, hera e parë ishin plot fmi në kopsht, familiarizim, edhe u mendova i kanë thirrë fqinj tonë, atë katundin me fmitë edhe kanë mush qaty. Edhe thashë hajt po bojme, "A mundesh me shkrujt pemën e familjes? Ky është axhi, ky është kushëri qikjo kushëri..." thashë, "Kuku, krejt qiky kopsht o famili im?" Thashë, kanë thirrë krejt katundin, por jo, në qat' kopsht ishin fmitë të axhës, fmitë e fmive të axhës, secili person ka pesë [fmi]. Unë dhe tre motra me babain kishim ardh, që domethonë plot kemi bo ni pemë të familjes, edhe plot kusha janë kanë aty, jam unë, jam unë {bën me gisht kah vetja edhe familjarë tjerë} ... e kisha lidhur krejt me ato edhe më ka ardh mirë... plus ngroht, plus me pasion. Se jena popull i shtypur, atëhere jeni konë popull shtypur edhe jeni ma... edhe keni dashtë lirinë ma shumë si pasuni ose diçka tjetër. E me bo me pytë dikush në Kosovë, "Çka po donë?" Po thotë, "Liri." Nuk thotë, "Du patika Jordan ose Adidas ose qita, qita..." thotë, "Jo, jo, po du liri", edhe fmitë me i pytë atëherë thotë, "Shkollën po du, edukimin po du", vetë thotë, a din, liri, edukimi, e jo adidas e kshu a po ...

**Lura Limani:** Ju kur keni ardhë në Prishtinë, Univerziteti hala ka qenë në ndërtesa, apo?

**Lala Meredith-Vula:** Fakultet ishin ndërtesa, Akademia e Artit ishin, nuk ishin ku është tash, po u konë, ka pasë vend... se Universiteti Prishtinës keni themelmu vitin '70 më duket, ishin Akaedimi Arti, ishin Musli Mulliqi m'duket, aty ishin do farë piktura të njohura Xhavadet Xhafa. Plus babai im ka qenë intelektual të arkitekturës, e kshu më pëlqen, njofim njoni-tjetrin si vend I vogël edhe vend lidhur me njoni-tjetrin kshut.

Edhe atëhere, bile atëhere kur mama ime [vitet] '60, merre me mend, mama ime ka martu ne '60 me ni shiptar, por ish në Beograd t'u jetu po kur po thotë po martona me ni shqiptar ato në Beograd thanë, "Kuku, kuku, a je çmend?" Sepse reputacion edhe propaganda të këqij kishin thonë të gjithë, "Në Kosovë janë të egër", por mama jem tha, "Jo, martona me shqiptar". Edhe qe, jam bo une, [më kanë] kriju mu...

**Lura Limani:** Thatë ma herët që vini shpesh në Kosovë, a keni lidhje me njerz ktu?

**Lala Meredith-Vula:** Po, kam lidhje me shumë njerëz edhe bile mos trego që jam ktu se nuk [kam]

kohe me ardh në Gjakove. M'fal ksaj radhe nuk e boj Gjakovës, se duhet me pi ka 1000 çaj, e ka 1000 kafe e plus është shumë i mirë, se është ngroht e kupton? Është luftë me kon kom me flejt në Gjakova, valigjja jem lufton prej stacion, “Ki me bujt te unë, jo te une, jo...”, edhe a din nuk po shkoj ksaj [here] vizitë [në] Gjakovë se po boj knena, knena edhe vizitë tjetër po boj Gjakovë direkt. E po thom, ishalla nuk ma qesin në facebook që jam në Kosovë.

**Lura Limani:** S’e qesim, s’e qesim menihere...

**Noar Sahiti:** Masi që të shkojsh ...

**Lala Meredith-Vula:** Jo, se po thojnë, “Pse, ke ardh, e nuk ke ardh për çaj?” Domethanë, në Gjakovë...Jo, po...çka me thonë?

**Lura Limani:** Para se me kry veç desha me ju pyet, a jeni tu punu naj projekt specifik?

**Lala Meredith-Vula:** Po unë vazhdoj me artin tim edhe po du me bo ekspozita ma shumë edhe plus jam duke shiku arkivin që kom bo atehëre se si fotografi bon shumë shkrepje edhe nuk sheh çka ki. Po i qes në arkiv edhe vazhdon me jetën se s’ki kohë me kqyr çka ki bo vjet.

E tash jom mrapa t’u shiku krejt fotografijat e kam në negative se e rujn shume bukur atje, plus se juve me digjital nuk e din çfarë format ki me bo fotografi, ti për shembull, bon detaj të vogla e s’mundesh me zmadhu pastaj... Ama, me film mundesh me skanu shumë detaj edhe me bo ni fotografi si q’ai mur e boj e me krejt detaj. Se për shembull, në pajtimi i gjaqeve kam bo fotografi e tubimi,t e merre me me mend e kam zmadhu tre metra me dy metra në e qit’ Galeri Kombetare e Artit. A je kon? Po? A je kon ti? [E pyet intervistuesen dhe kamerapersonin]

**Noar Sahiti:** Jo...

**Lala Meredith-Vula:** Haaa gabim, e aty kishe mujt me pa njerz prej larg në kodra, nji çifti për shembull... tubimi qitu ftyrën çdo person qikaq i madh {shpjegon me duar} me nje film negative e... e me bo, me bo me digjital e boj ato *pixels* e nuk e shoh ftyrën me bo me zmadhu qikaq e madhe... qato është vjetër, ma mirë osht’ vjetër ma mirë jam, që domethonë sot për sot jam t’u shiku arkivimin, jom t’u skanu, por duhet kohë. E du me bo ekspozita, me bo gjithë se e kam si, qysh me thonë? *Treasure* [thesar] *like* [si] thesar... thesar, e si thesarin e madhe.